

LIGJ
Nr.8419, datë 28.10.1998

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7788, DATË 9.2.1994; NR.7899, DATË 2.2.1995; NR.8079, DATË 29.2.1996; NR.8171, DATË 6.2.1997; NR.8248, DATË 6.10.1997; NR.8338, DATË 30.4.1998; NR.8349, DATË 20.5.1998

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.7788, datë 9.2.1994; nr.7899, datë 2.2.1995; nr.8079, datë 29.2.1996; nr.8171, datë 6.2.1997; nr.8248, datë 6.10.1997; nr.8338, datë 30.4.1998; nr.8349, datë 20.5.1998 në nenin 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Taksë mujore e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen".

Neni 2

Në nenin 7 "Për taksat nacionale", pas shkronjës "p" shtohet shkronja "q" me këtë përmbajtje:
"Taksa mujore e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen caktohet sipas lidhjes nr.9.

Të ardhurat nga vjelja e kësaj takse destinohen për Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Mbrojtjes."

Neni 3

Në nenin 8, në shkronjën "A" "Për taksat nacionale", lidhur me organet që merren me vjeljen e taksave, pas shkronjës "n" shtohet shkronja "nj" me këtë përmbajtje:

"Për vjeljen e taksës mujore të solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e rendit Publik."

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekreten nr.2247, datë 3.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIDHJA NR.9
TAKSA MUJORE E SOLIDARITETIT PËR RENDIN DHE MBROJTJEN

	Lekë
1. Subjekte shtetërore të regjistruara në TVSH	100 000
2. Subjekte private të regjistruara në TVSH	5 000
3. Biznesi i vogël në qytet	2 000
4. Biznesi i vogël në fshat	1 000
5. Punonjësit buxhetorë me pagë mujore 10 000 lekë e lart	500
6. Punonjësit jobuxhetorë me pagë mujore 10 000 lekë e lart	500
7. Punonjësit e sektorit privat me pagë mujore 10 000 lekë e lart	500
8. Shtetasit shqiptarë që dalin nga portet, aeroportet, pikat e kalimit kufitar për çdo dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë	1 000